



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 486/2 Prot.

Vlorë, më 30. 03. 2021

VENDIM

Nr. 9, datë 19. 03. 2021

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PAGESËS SË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR
STUDENTËT QË NDJEKIN VITIN E PARË TË STUDIMIT NË PROGRAMIN E
INTEGRUAR NË DREJTËSI**

Në mbështetje të nenit 38, të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 19, 25 pika 1, gërma i, të Statutit të UV-së, si dhe referuar shkresës së Dekanit të Fakultetit të Shkencave Humane nr. 478 prot, datë 18. 03. 2021 si dhe shkresës nr. 118 prot, datë 17. 03. 2021 të Përgjegjësit të Departamentit të Drejtësisë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 19. 03. 2021,

VENDOSI

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, shtyrjen e afatit shtesë për pagesën e tarifës së shkollimit, për studentët që ndjekin vitin e parë të studimit në programin e Integruar në Drejtësi deri në datën 30. 04. 2021. (Bashkëlidhur shkresa nr. 478 prot, datë 18. 03. 2021 e FSHH si dhe shkresa nr. 118 prot, datë 17. 03. 2021 e Përgjegjësit të Departamentit të Drejtësisë).
2. Ky vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE

ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS

NR. 478 PROT.

DATA 18.03. 2021

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEKANI

Nr. 113/1 prot.

Vlorë, më 17.03. 2021

Lënda: Përcjellje e problematikës në lidhje me regjistrimin e studentëve të Departamentit të Drejtësisë

PROF. DR. ROLAND ZISIT, REKTOR I UV-së

Këtu

I nderuar Z. Rektor,


Bashkëlidhur Ju përcjell problematikën në lidhje me regjistrimin e studentëve të Departamentit të Drejtësisë, shkaktuar nga pamundësi të ndryshme për të paguar tarifën vjetore të shkollimit. Arsyet e konstatuara paraqiten në shkresën bashkëlidhur të përgjegjësit të Departamentit të Drejtësisë.

Lutemi adresimin e kësaj çështjeje nga ana Juaj dhe/ose përcjelljen e saj për diskutim dhe shqyrtim në organet përkatëse vendimmarrëse: Rektorat, Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin.

DEKAN

Prof. As. Dr. Armela Panajoti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I DREJTËSISË

Nr. 118.....Prot.

Vlorë, më 17.03.2021

Lënda: Përcjellje problematike mbi regjistrimin e disa studentëve të Departamentit të Drejtësisë në sistemin UVMS

DEKANIT PROF. ASOC. ARMELA PANAJOTI
Fakultetit të Shkencave Humane, Universiteti 'Ismail Qemali', Vlorë

Në kuadër të procesit të hedhjes së vlerësimeve për provimet e sezonit Vjeshtë 2020 në Departamentin e Drejtësisë, nga stafi akademik dhe sekretaria mësimore janë evidentuar raste të shpeshta të studentëve frekuentues në leksione dhe pjesëmarrës në provime, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në sistemin UVMS. Sipas arsyeve të vëna në dispozicion nga vetë studentët, ky problem vjen për shkak të mospagimit të taksës vjetore shkollore dhe, në raste të veçanta, për shkak të mosmarrjes në kohë të përgjigjeve të aplikimeve për bursë. Sipas informacionit të përcjellë ditën e sotme nga Zyra e studentit pranë FSHH, rezulton si vijon:

Programi Bachelor në Drejtësi/ Master i shkencave në Drejtësi:

Viti I, (5 Vjeçar) nga 105 studentë në total kanë paguar tarifën 65 dhe 40 janë debitorë
Viti II, nga 162 në total kanë paguar tarifën 110 dhe 52 janë debitorë
Viti III, nga 167 në total kanë paguar 110 dhe 57 janë debitorë

Programi Master Profesional "E drejte penale":

Viti I, nga 31 studentë në total 23 paguar dhe 8 janë debitorë
Viti II, nga 42 studentë në total 31 paguar dhe 11 janë debitorë

Programi Master Profesional në "Shkenca administrative":

Viti I, nga 27 studentë në total kanë paguar 25 dhe 2 janë debitorë
Viti II, nga 37 studentë në total kanë paguar 24 dhe 13 janë debitorë

Programi Master shkencor në "Marrëdhënie Ndërkombëtare":

Viti I, nga 47 studentë në total kanë paguar 36 dhe 11 janë debitorë
Viti II, nga 24 në total 19 kanë paguar dhe 5 janë debitorë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE
DEPARTAMENTI I DREJTËSISË

Në kushtet e përfundimit të të gjitha afateve të plotësimit dhe dorëzimit të proces-verbaleve për këtë sezon, lutemi t'i përcillet Rektoratit, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit ky shqetësim për të arritur në një zgjidhje të kënaqshme dhe të pranueshme, dhe në të njëjtën kohë duke mos krijuar asnjë lloj precedenti.

Në lidhje me problematikën e studentëve që kanë bërë kërkesë për bursë studimi por që nuk kanë marrë ende një përgjigje, do të sygjeronim rregjistrimin e tyre me kusht deri në kthimin përfundimtar të përgjigjes së bursës.

Për sa i përket studentëve që nuk e kanë paguar taksën për arsye ekonomike, sygjerojmë regjistrimin paraprak me kusht nga sekretaria, dhe dhënien kohë shtesë të arsyeshme me qëllim moshumbjen e së drejtës së vlerësimit të marrë në këtë sezon provimesh.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

PhD Erjon Hitaj
Drejtues i Departamentit